**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut**
**Drejtoria e statistikës**

Shkup, 21 mars 2025

## Njoftim për shtyp

## Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: shkurt 2025

– Në shkurt 2025, **paraja e gjerë (agregati monetar M3[1,2])** realizoi rritje mujore prej 0,2%, nën ndikim të rritjes së parave të depozitave dhe depozitave afatgjata deri në dy vite, ndërsa depozitat afatshkurtëra dhe paratë e gatshme në qarkullim shënojnë ulje. Rritja vjetore e parasë së gjerë arrin 9,2% dhe kryesisht vjen nga rritja e parave të depozitave dhe depozitat afatgjata deri në dy vite, me kontribut më të vogël pozitiv nga paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat afatshkurtëra.

– **Totali i depozitave[3]** në shkurt u rrit për 0,4% në bazë mujore, tërësisht si rezultat i rritjes së depozitave në sektorin "amvisëri", me rënie të depozitave në sektorin korporativ. Krahasuar në nivel vjetor, shënohet rritje prej 11,1%, shkaku i rritjes së depozitave në të dy sektorët, me kontribut më të shprehur te rritja e depozitave në sektorin "amvisëri".

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

| | gjendja (në milionë denarë) | | | | | | ndryshimet vjetore (во %) | | | | | | ndryshimet mujore (në %) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 |
| **Paraja e gjerë M4** | **591,336** | **607,881** | **616,771** | **663,295** | **654,804** | **656,964** | **9.5** | **7.6** | **8.6** | **11.4** | **10.4** | **10.4** | **-0.7** | **0.5** | **-0.7** | **5.1** | **-1.3** | **0.3** |
| **Paraja e gjerë M3** | **521,804** | **535,985** | **540,047** | **583,268** | **573,827** | **575,098** | **6.6** | **5.4** | **6.7** | **10.2** | **9.1** | **9.2** | **-0.9** | **0.4** | **-1.2** | **5.6** | **-1.6** | **0.2** |
| *nga të cilat:* | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| *Paratë në qarkullim* | 49,336 | 51,377 | 52,062 | 56,226 | 55,214 | 54,912 | 8.6 | 7.6 | 9.9 | 12.4 | 14.9 | 13.0 | 1.5 | 2.2 | -1.9 | 7.2 | -1.8 | -0.5 |
| *Depozitat e parave* | 202,074 | 211,126 | 212,711 | 236,065 | 228,940 | 230,669 | 11.4 | 8.8 | 11.3 | 11.7 | 10.7 | 12.0 | -1.9 | 0.3 | -0.9 | 8.3 | -3.0 | 0.8 |
| *Depozitat afatshkurta* | 215,551 | 215,501 | 212,930 | 223,172 | 221,667 | 220,443 | 1.0 | 0.1 | -2.0 | 3.4 | 1.7 | 1.2 | -1.1 | 0.2 | -2.3 | 4.0 | -0.7 | -0.6 |
| *Depozitat afatshkurta deri në 2 vjet* | 54,842 | 57,981 | 62,345 | 67,805 | 68,006 | 69,074 | 10.8 | 12.7 | 23.9 | 30.4 | 27.9 | 27.7 | 1.4 | 0.0 | 3.0 | 0.8 | 0.3 | 1.6 |
| **Totali i depozitave** | **531,140** | **544,683** | **555,602** | **600,389** | **592,750** | **595,277** | **9.3** | **7.2** | **8.8** | **12.4** | **11.0** | **11.1** | **-0.9** | **0.4** | **-0.4** | **5.3** | **-1.3** | **0.4** |
| *nga të cilat:* | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Sektori korporativ | 150,674 | 153,830 | 158,056 | 176,284 | 167,507 | 165,805 | 12.2 | 4.7 | 4.7 | 9.2 | 5.7 | 7.4 | -2.4 | 1.0 | -0.5 | 8.7 | -5.0 | -1.0 |
| *Në denarë* | 100,009 | 103,684 | 107,476 | 119,191 | 114,012 | 114,646 | 12.5 | 5.6 | 7.9 | 9.1 | 6.2 | 10.5 | -3.6 | 1.7 | 0.6 | 6.4 | -4.3 | 0.6 |
| *Në valutë të huaj* | 50,664 | 50,146 | 50,580 | 57,093 | 53,495 | 51,159 | 11.4 | 2.8 | -1.5 | 9.4 | 4.6 | 1.1 | 0.1 | -0.4 | -2.8 | 13.8 | -6.3 | -4.4 |
| Amvisëritë | 354,741 | 364,432 | 372,219 | 396,901 | 397,793 | 400,785 | 8.7 | 8.9 | 11.2 | 13.8 | 14.2 | 13.1 | 0.1 | 0.0 | 0.1 | 3.9 | 0.2 | 0.8 |
| *Në denarë* | 177,631 | 184,627 | 190,026 | 212,507 | 212,574 | 215,117 | 13.7 | 13.1 | 18.0 | 22.5 | 24.2 | 21.8 | 0.6 | -0.6 | -0.3 | 7.4 | 0.0 | 1.2 |
| *Në valutë të huaj* | 177,109 | 179,805 | 182,194 | 184,394 | 185,220 | 185,669 | 4.0 | 4.8 | 4.9 | 5.2 | 4.5 | 4.5 | -0.3 | 0.5 | 0.6 | 0.2 | 0.4 | 0.2 |

Burimi: BPRMV-ja.

[1] Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si përkufizim të ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.
[2] Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe paratë e depozituara. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati monetar M1 së bashku me depozitat afatshkurtëra, përderisa agregati monetar M3 (paraja e gjerë), përkrah agregatit monetar M2, i përfshinë edhe depozitat me maturim prej një deri në dy vite. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 e ruan agregatin monetar M3 dhe depozitat afatgjata me maturim më shumë se dy vite. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë:
https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija%20_monetarna_07_2021_al.pdf
[3] Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshira në agregatin monetare M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.

– Në shkurt, **totali kredive**, shënoi rritje për 1,1% dhe përkatësisht 11,5% në bazë mujore dhe vjetore. Ndryshimi në të dy bazat është rezultat i rritjes së kerditimit në dy sektorët, me kontribut më të shprehur në rritjen e kredive të sektorit korporativ.

Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar

| | gjendja (në milionë denarë) | | | | | | ndryshimet vjetore (во %) | | | | | | ndryshimet mujore (në %) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | 1.2025 | 2.2025 |
| **Totali i kredive** | **449,251** | **462,435** | **469,266** | **494,449** | **494,098** | **499,497** | **6.1** | **6.4** | **7.5** | **11.2** | **11.3** | **11.5** | **0.3** | **0.8** | **0.4** | **2.7** | **-0.1** | **1.1** |
| *nga të cilat:* | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Sektori korporativ | 214,268 | 221,765 | 223,900 | 242,338 | 241,446 | 244,967 | 5.4 | 5.8 | 7.5 | 13.9 | 14.2 | 14.3 | 0.0 | 0.6 | -0.1 | 4.4 | -0.4 | 1.5 |
| *Në denarë* | 134,280 | 144,110 | 149,795 | 166,560 | 165,184 | 168,788 | 11.9 | 16.2 | 19.7 | 27.1 | 27.2 | 27.0 | 1.0 | 2.6 | 0.9 | 5.2 | -0.8 | 2.2 |
| *Në valutë të huaj* | 79,988 | 77,656 | 74,104 | 75,777 | 76,262 | 76,179 | -3.9 | -9.3 | -10.9 | -7.2 | -6.4 | -6.3 | -1.7 | -2.8 | -2.1 | 2.7 | 0.6 | -0.1 |
| Amvisëritë | 232,313 | 238,057 | 242,919 | 249,532 | 250,139 | 251,899 | 6.8 | 7.1 | 7.7 | 8.8 | 8.8 | 8.9 | 0.5 | 1.0 | 0.8 | 1.1 | 0.2 | 0.7 |
| *Në denarë* | 126,809 | 130,453 | 133,210 | 136,079 | 136,638 | 137,629 | 5.8 | 7.2 | 7.6 | 8.7 | 8.8 | 8.9 | 0.3 | 1.2 | 0.8 | 0.6 | 0.4 | 0.7 |
| *Në valutë të huaj* | 105,504 | 107,603 | 109,709 | 113,454 | 113,501 | 114,269 | 8.1 | 7.0 | 7.8 | 8.9 | 8.7 | 9.0 | 0.6 | 0.7 | 0.8 | 1.7 | 0.0 | 0.7 |

Burimi: BPRMV-ja.







Burimi: BPRMV-ja.

## 1. Depozitat dhe kreditë e sektorit korporativ[4]




Burimi: BPRMV-ja.

[4]Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin shoqëritë publike dhe private jofianciare.

- Totali i **depozitave në sektorin korporativ**, në shkurt realizoi ulje mujore prej 1,0% si rezultat i rënies së depozitave në valutë të huaj, ndërsa komponentet tjera shënuan rritje. Rritja vjetore është 7,4% dhe vjen si pasojë e rritjes së parave të depozitave dhe depozitave afatshkrutëra në denarë dhe depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, me rënie të depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj.

- Në shkurt, **kreditë e sektorit korporativ**[5], shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 1,5%, respektivisht 14,3%. Njëkohësisht, ndryshimi mujor dhe vjetor tërësisht vjen nga rritja e kreditimit në denarë, me rënie të kredive në valutë të huaj.







Burimi: BPRMV-ja.

## 2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive[6]




Burimi: BPRMV-ja.

---

[5]Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.
[6]Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë.

- **Totali i depozitave të amvisërive**, në shkurt u rrit për 0,8% në raport me muajin paraprak, kryesisht nën ndikim të rritjes së parave të depozitave dhe depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj dhe më pak të depozitave afatshkurtëra në denarë dhe në valutë të huaj. Depozitat e amvisërive shënojnë rritje vjetore prej 13,1% si rezultat i rritjes së parave të depozitave dhe depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, në kushte të rënies së depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë.

- Këtë muaj, **kreditë e amvisërive**, shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 0,7%, përkatësisht 8,9%. Ndryshimi në të dy bazat është rezultat i rritjes së kredive në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të madh të kredive në denarë.







Burimi: BPRMV-ja.




Burimi: BPRMV-ja.

Tabela 3. Kreditë e bankave dhe kursimoreve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit

| | gjendja (në milionë denarë) | | | | | | ndryshimet vjetore (në %) | | | | | | ndryshimet mujore (në %) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | I.25 | II.25 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | I.25 | II.25 | 3.2024 | 6.2024 | 9.2024 | 12.2024 | I.25 | II.25 |
| Kreditë konsumatore | 119,858 | 122,857 | 125,233 | 128,863 | 128,466 | 129,594 | 5.8 | 5.8 | 6.7 | 7.5 | 8.4 | 8.5 | 0.4 | 0.8 | 0.6 | 1.3 | -0.3 | 0.9 |
| Kreditë për banesa | 85,555 | 87,920 | 90,191 | 94,398 | 94,853 | 95,946 | 10.4 | 10.2 | 11.0 | 12.5 | 12.7 | 13.3 | 1.0 | 0.9 | 1.0 | 2.3 | 0.5 | 1.2 |
| Kreditë për automjete | 399 | 419 | 430 | 418 | 420 | 417 | 13.1 | 14.6 | 13.5 | 4.7 | 5.1 | 6.5 | 1.8 | 2.1 | -0.6 | -2.9 | 0.7 | -0.8 |
| Kartat e kreditit | 9,459 | 9,332 | 9,184 | 8,934 | 8,833 | 8,677 | -6.8 | -8.0 | -9.0 | -9.2 | -9.0 | -9.0 | -0.8 | -0.3 | -0.8 | -1.9 | -1.1 | -1.8 |
| Bilancet negative të llogarive rrjedhëse | 6,820 | 6,846 | 6,857 | 5,738 | 6,390 | 6,335 | 6.1 | 7.9 | -1.9 | -4.4 | -4.6 | -5.0 | 2.3 | 5.7 | 4.6 | -13.5 | 11.4 | -0.9 |
| Kreditë e miratuara mbi baza të tjera | 1,658 | 1,579 | 1,563 | 1,568 | 1,549 | 1,527 | -21.2 | -18.8 | -17.5 | -12.0 | -10.2 | -9.5 | -1.7 | -2.0 | 0.7 | 0.2 | -1.2 | -1.5 |

Burimi: BPRMV-ja.

– Analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizik, në shkurt te **kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të përfaqësuara, është shënuar rritje mujore prej 0,9% dhe përkatësisht 1,2%, me rritje vjetore prej 8,5% dhe përkatësisht 13,3%. Këtë muaj, **kreditë për automjete** u ulën për 0,8% në bazë mujore, ndërsa në bazë vjetore shënojnë rritje prej 6,5%. Këtë muaj, kreditë e miratuara për **kartelat kreditore** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej 1,8%, respektivisht, 9,0%. Në shkurt, te **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** dhe kreditë e miratuara në **baza tjera** shënojnë rënie mujore prej 0,9%, përkatësisht 1,5%, me rënie vjetore prej 5,0%, përkatësisht 9,5%.

***

**Informacione mbështetëse**

Seri kohore e të dhënave: Bilance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore https://www.nbrm.mk/monetarna_statistika-al.nspx

Shpjegime metodologjike:
https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija%20_monetarna_07_2021_al.pdf

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:
https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija%20_monetarna_07_2021_al.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave
https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendari_i_publikimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 17 prill 2025 (mesatare referuese, përshirë marsin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokali 02/3215-235). 108/110.